VENDIM
Nr. 11, datë 21.1.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "LAJTHIZA INVEST" SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC "QAMI 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 98 prot., datë 18.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Lajthiza Invest' sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Qami 1', me kapacitet të instaluar 1.730 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Lajthiza Invest" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 11 prot., datë 5.1.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC "Qami 1", në përroin e Srriqës, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqës, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Lajthiza Invest" sh.a. rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa "f", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a" dhe "d", plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, germat: "a", "c", "d", "f", plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat "b" dhe "c", plotësuar.

- Dokumentacioni i plotësuar pjesërisht apo i munguar ka të bëjë me:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1:

- germa "a" (të dhëna për aplikimin), shoqëria duhet të plotësojë formatin e aplikimit në të gjithë zërat e tij, së bashku me llojin e aplikimit;

- germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit), shoqëria duhet të plotësojë formatin e aplikimit në të gjithë zërat e tij;

- germa "c" (të dhëna për aplikuesin), shoqëria duhet të depozitojë të plotësuar formatin për këtë pikë të rregullores;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germat "a", "b" (akti i themelimit/statuti), shoqëria ka depozituar aktin e themelimit të shoqërisë, të hartuar në momentin e themelimit të saj, dhe një statut të shoqërisë, që edhe pse nuk ka datën e nënshkrimit, në nenet e tij rezulton se është bazuar në legjislacionin për shoqëritë tregtare të vitit 2008, që është disa vite më vonë se akti i themelimit dhe nuk është nënshkruar nga të njëjtat palë themeluese të shoqërisë, ndaj shoqëria duhet të informojë ERE-n për sa depozituar dhe kronologjinë e këtyre akteve të brendshme të funksionimit të saj;

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)), shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për regjistrimin dhe ekstraktin historik të plotë;

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridik, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata)), shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës, për administratorin dhe vetë shoqërinë, për të gjitha vendet e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik-elektrik), shoqëria duhet të përcjellë strukturën e ndërtimit dhe licencën e drejtuesit teknik, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores;

- germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shit-blerjeje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shit-blerjeje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme etj.)), shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacionin përkatës të vlefshëm në lidhje me pronësinë në të gjithë zonën ku do të shtrihet projekti, pasi kontratat e depozituara prej saj e kanë humbur vlefshmërinë. Po ashtu, shoqëria të bëjë me dije nëse kontrata me MIE-n është regjistruar në zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive, e nëse po, të depozitojë dokumentacionin përkatës, me qëllim që të verifikohet i gjithë dokumentacioni pronësor dhe koordinatat përkatëse të shtrirjes së projektit për ndërtimin e HEC “Qami 1”;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3:

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.)), shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës për aftësinë apo mbështetjen financiare, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores;

- Dokumentacionin teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3:

- germa “b” (një diagram elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes), shoqëria duhet të depozitojë diagramin elektrike përkatëse për HEC “Qami 1”;

- germa “c” (shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre) të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000), shoqëria duhet të depozitojë këtë dokument, sipas kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores;

- Dokumentacionin tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4:

- germa “a” (studimi i fizibilitetit teknik bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projekteve, ku të përfshihen: përshkrim i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të centralit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të centralit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin dhe transmetimin e energjisë; studim dhe analizë e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku zbatohet projekti), shoqëria duhet të përcjellë në ERE studimin e fizibilitetit, sipas kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores;

- Lejen nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5:

- germa “a” (miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), shoqëria duhet të përcjellë në ERE miratimin përkatës për lidhjen e centralit me rrjetin elektrik.

- Shoqëria ka bërë me dije se parashikonte fillimin e operimit në datën 15.9.2021, ndërkohë që nuk është pajisur ende me licencë nga ERE, e po ashtu nuk ka ndonjë dokument tjetër apo informacion nga ana e shoqërisë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet ndërtimi i HEC. Për këtë arsye shoqërisë do t’i kërkohet të depozitojë lejen e ndërtimit, të bëje me dije ERE-n nëse kanë filluar punimet e HEC dhe nëse po, fazën në të cilën ndodhen ato. Në rast se punimet kanë

përfunduar dhe impianti është kolauduar apo testuar, atëherë do t'i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE aktin e kolaudimit apo testimit.

- Referuar raportit të oponencës teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të depozituar nga shoqëria, rezulton se vlera totale e investimit sipas projektit të zbatimit nuk përkon me vlerën e investimit të përcaktuar në kontratën nr. 2856 rep., nr. 1350/1 kol., datë 22.12.2017, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Në këto rrethana shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-s se ku qëndron ky ndryshim në vlerën e investimit.

- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria për qëllim të këtij aplikimi është në formatin fotokopje, ndaj do t'i kërkohet shoqërisë, që në zbatim të nenit 8, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, të depozitojë këtë dokumentacion dhe atë të munguar apo të plotësuar pjesërisht në versionin origjinal ose fotokopje të noterizuar, brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e sipërcituar.

- Në dosjen e aplikimit është depozituar dhe dokumentacioni që i referohet Stabilimentit të Ujit Lajthiza apo ndërtimit të nënstacionit 110/20 kV "Lajthiza". Vlerësohet që në vijim do të saktësohet/sqarohet me shoqërinë se dokumentacioni që duhet plotësuar, në lidhje me këtë aplikim, duhet të lidhet me centralin HEC "Qami 1".

- Kontrata nr. 2856 rep., nr. 1350/1 kol., datë 22.12.2017, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Qami 1', me kapacitet 1.730 mw, në përroin e Srriqës, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqës, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës", lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë "Lajthiza Invest" sh.a., ka një afat 49-vjeçar, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Lajthiza Invest" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Qami 1", me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti